

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

24.03.2023

Ora 12:11

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shpalljen e vendimeve për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për raportimin e veprimtarive publike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve                      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:    **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**  
**Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**    **S’ka**
- **Të tjerë**    **Qëndresa Qytetare, KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje:

1. Për shpalljen e vendimeve për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 3 mars – 9 mars 2023.
3. Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 10 mars – 16 mars 2023.
4. Projektvendim “Për zbatimin e vendimit numër 30. Dt. 21.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, për regjistrimin e partisë politike “Aleanca Progresiste”. Fillojmë me pikën e parë, “Për shpalljen e vendimeve për

**Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

**Znj. M. Koja:** Atëherë Komisioner, duke qenë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar një sërë denoncimesh për disa institucione publike, të cilat mbartin detyrim për të raportuar në KQZ veprimtaritë e tyre publike. Është përfunduar hetimi administrativ për institucionet si vijon:

Bashkia Korçë, Bashkia Patos, Bashkia Maliq, Prefekti i Qarkut Durrës, Enti Kombëtar i Banesave, Bashkia Belsh, Bashkia Kukës, Bashkia Gjirokastrë, Autoriteti i Konkurrencës, Bashkia Tiranë, Bashkia Kavajë. Për sa i përket këtyre institucioneve ne propozojmë pushimin e procedimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes nga këto institucione për shkak se mosraportimi rezulton për shkaqe të përligjura, jashtë vullnetit të këtyre institucioneve. Ndërkohë propozojmë gjithashtu pushimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sipas denoncimit të administruar, nuk është raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari. Një veprimtari publike në të cilën pretendohet se ka shpërdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste”, përmes promovimit të investimeve në spitalin e Lezhës. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga kqyrja e materjaleve filmike, nuk rezulton që në këtë aktivitet të jenë mbajtur deklarata apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve, por deklarimet kanë të bëjnë me zhvillimin e politikave të të gjithëve dhe shtetëror në fushën e shërbimit, të kujdesit shëndetësor. Nga ana tjetër verifikohet se veprimtaria është e raportuar. Rezulton e raportuar në datën 2 shkurt 2023, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Gjithashtu është administruar denoncim nga Partia Demokratike, dega Elbasan ndaj disa institucioneve të Bashkisë Elbasan, ku pretendohet se Bashkia

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

Elbasan, Ujësjellës Kanalizime Elbasan, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Zyra Vendore Arsimore, Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit dhe Kujdesit Shqëndetësor Elbasan, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan, Drejtoria Rajonale e Punësimit Elbasan, kanë kryer veprimtari të ndaluara në kundërshti me vendimin nr. 9, duke kryer punësime në periudha të ndryshme pas janarit 2023. Të gjitha këto institucione kanë dhënë shpjegimet e tyre, madje një pjesë e tyre i kanë dhënë dhe në seancën publike të herës së kaluar. Ne Konkludojmë se veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar në rast se do të ishte kryer gjatë fushatës zgjedhore dhe në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi sikundër Kodi Zgjedhor parashikon. Neni 77, pika 1 i Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjes dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Në këto kushte ne sugjerojmë të mos konstatohet shkelje administrative nga ana e këtyre institucioneve. Ky është vendimi i parë për të cilin propozojmë të merret sot pushimi i procedurës administrative ndaj këtyre institucioneve: Bashkia Korçë, Bashkia Patos, Maliq, Prefekti i Qarkut Durrës, Enti Kombëtar të Banesave, Bashkia Belsh, Bashkia Kukës, Bashkia Gjirokastrë, Autoriteti i Konkurrencës, Bashkia Tiranë, Bashkia Kavajë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe disa institucione të Bashkisë Elbasan përfshirë edhe Bashkinë Elbasan.

**Z. I. Celibashi:** Mirë vazhdojmë me relatimin dhe me pikat e tjera dhe pastaj në fund bëjmë vlerësimin dhe deklarimin e vendimeve përkatëse.

**Znj. M. Koja:** Dakord! Ndërkohë, për sa i përket denoncimeve ndaj Bashkisë Fier për 3 veprimtari publike të raportuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për të cilat është pretenduar në denoncim se janë keqpërdorur burimet publike në

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

funksion të fushatës zgjedhore të ardhshme. Nga verifikimi i kryer ne konkludojmë se referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit “Për statusin e deputetit”, ai gëzon një status të veçantë në marrëdhënien juridike që ka me të gjitha organet qendrore dhe vendore në vend. Pjesëmarrja e tij në një aktivitet të organizuar nga kryetari i bashkisë nuk e kthen domosdoshmërisht aktivitetin në një takim elektorale. Si pjesë e detyrave funksionale të tij deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë. Megjithatë këto takime nuk duhet të shfrytëzohen për kryerjen e thirrjeve elektorale, apo për sjelljen e mesazheve me përmbajtje të tillë siç ka ndodhur në të treja aktivitetet e Bashkisë Fier. Pra pjesëmarrja e deputetit në vetvete ne mendojmë që nuk është e ndaluar, por gjatë këtyre aktiviteteve nuk mund të bëhen thirrje partiake në mbështetje të njëjës apo tjetrës forcë politike apo candidate në zgjedhje. Në këto kushte ne i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të ndërmarrë sanksion administrative ndaj Kryetarit të Bashkisë Fier. E njëjta situatë është me Bashkinë Përrenjas, për një veprimtari publike të raportuar. Edhe aty ka pjesëmarrje të një deputeti dhe gjatë zhvillimit të veprimtarisë nga sa është kqyrur nga materialet e vëna në dispozicion, ka thirrje për të votuar, apo preferenciale për një forcë të caktuar politike. E njëjta situatë është edhe me Bashkinë Librazhd dhe për të treja këto raste ne i propozojmë Komisionerit që të vendosë propozimin e masës administrative, sanksion ndaj kryetarëve të tre bashkve, Fier, siç e citova më lart, Përrenjas dhe Librazhd. Ndërkohë për sa i përket disa institucioneve të tjera, të cilat nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për të raportuar, ne propozojmë ndërmarrjen e sanksionit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin në KQZ, ndaj këtyre institucioneve: Bashkia Poliçan, për 2 veprimtari publike të raportuara dhe justifikimet e tyre nuk janë të përligjura, Bashkia Skrapar për 1 veprimtari publike

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

të paraportuar, Bashkia Roskovec për 1 veprimtari publike të paraportuar, Bashkia Lezhë për 6 veprimtari publike të paraportuara, Bashkia Bulqizë për 1 veprimtari publike të paraportuar, Bashkia Lushnje për 2 veprimtari publike të paraportuara, Ministri i Shtetit për Mrojtjen e Sipërmarrjes për 1 veprimtari publike të paraportuar, Bashkia Elbasan për 3 veprimtari publike të paraportuara, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë për 1 veprimtari publike të paraportuar. Në rastin konkret, nga hetimi konstatohet se detyrimi për raportim i përket Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, pasi ajo ka qenë organizatore e aktivitetit. Në këto kushte konstatohet se shkelja është kryer nga kjo ministri dhe jo nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë. Propozohet sanksion për personin përgjegjës për raportimin në këtë ministri. Realisht është shumë voluminoz, janë shumë institucione në fakt dhe në momentin përfundimtar do të kemi edhe vendimin të zbardhur dhe me arsyetimet përkatëse për secilin prej rasteve.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord! Vazhdojmë dhe me pikat e tjera, me vlerësimin e raportimeve për periudhën 3 mars - 9 mars dhe 10 mars – 16 mars 2023.

**Znj. M. Koja:** Ndërkohë nga ana tjetër krahas administrimit të denoncimeve vijon kryesisht monitorimi i ndërfaqes së raportimeve nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për periudhën 3 mars deri në datën 9 mars në ndërfaqe janë raportuar gjithsej 207 veprimtari nga 59 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto 40 veprimtari janë raportuar në tejkallim të afatit ligjor. Masraportimi në afat ka qenë për disa shkaqe si vijon. Në disa raste institucionet kanë qenë në cilësinë e të ftuarit dhe nuk e kanë patur detyrimin për të raportuar, por ndërkohë i është kërkuar dhe raportimi është bërë brenda afatit nga institucionet që kanë patur detyrimin për ta raportuar. Në disa raste problemet me aksesimin në ndërfaqe kanë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

qenë të përligjura. Për disa raste të tjera është krijuar bindja nga ana jonë se veprimtaria publike ka qenë një veprimtari me detyrim për tu raportuar, për shkak se ka qenë e mbyllur, ka qenë veprimtari brenda institucionit, pa pjesëmarrjen e mediave dhe pa pjesëmarrje të publikut. Ka patur dhe rast të keqlllogaritjes së afatit 5 ditor. Në këto kushte ne do të sugjerojmë që të përfundojmë shqyrtimin administrativ, të propozojmë pushimin e procedimit ndaj këtyre institucioneve: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar i Operës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prefekti i Qarkut Elbasan, Njësia Administrative nr. 9, Qendra Komunitare Multidisiplinare, bashkitë Belsh, Elbasan, Gjirokastrë, Gramsh, Kolonjë, Korçë, Lezhë, Maliq, Pogradec. Ndërkohë vijon raportimi për periudhën 10 mars - 16 mars. Jemi në shqyrtim të pretendimeve të paraqitura nga institucionet për sa i përket arsyeve për raportim jashtë afatit. Gjithsej janë raportuar 254 veprimtari. Nga këto 32 veprimtari janë në shkelje të afatit. Ndërkohë duam të sjellim në vëmendje që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po monitoron me baza ditore tashmë respektimin e detyrimit ligjor për të raportuar Brenda afatit dhe për të monitoruar keqpërdorimin e burimeve publike apo pjesëmarrjen e personave partiakë në këto veprimtari. Në këtë kuadër Komisioneri ka vendosur të ndalojë në ndërfaqen e raportimeve veprimtaritë si më poshtë: 1 rast për Bashkinë Kavajë, 3 raste për Bashkinë Gjirokastrë, 1 rast për Ministrinë e Kulturës dhe 1 rast për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Në lidhje me raportin për këto periudha kemi një përfaqësues nga një institucion.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

**Përfaqësuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve:** Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Ne kemi patur problem me aksesin në ndërfaqe. Duke qenë se jemi institucion varësie nga Ministria e Financave, na është kërkuar nga Ministria e Financave personi i cili do të kishte përgjegjësinë për raportimin. Ne i kemi dhënë të dhënat e mia dhe më pas ka qenë Ministria e Financave ajo që ka mbajtur korrespondencën me KQZ-në për të raportuar cilët do të ishin këta persona. Ne nuk na ishte hapur aksesin në kohën e duhur. Kemi qenë në kontakt vazhdimisht me Ministrinë e Financave duke qenë se ishin ata që mbanin korrespondencën me ju dhe sërish nuk na ishte hapur aksesin. Për të raportuar veprimtarinë që ishte në datën 18, në datën 13 i kam dërguar një email KQZ-së për këtë problematikë, duke qenë se nuk kisha akses në ndërfaqe. Aksesin më është hapur në datën 15 dhe pikërisht në këtë datë kam bërë raportimin e kësaj veprimtarie. Më tej është konstatuar shkelja e afatit për këtë rast sepse normalisht nuk respektohet afati 5 ditor, por e gjitha kjo ka ardhur për shkak se nuk kishim akses në ndërfaqe dhe aksesin është hapur në datën 15.

**Z. I. Celibashi:** I keni paraqitur me shkrim?

**Përfaqësuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve:** Po, kemi dërguar dhe emailin. Ditën e premte është konstatuar kjo dhe kam dërguar një email me këtë përgjigje të argumentuar në këtë formë që thashë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Institucione të tjera nuk kemi. Përfaqësuesi i Qëndresës apo nuk ishte pjesë e këtyre... Mirë faleminderit! Mirë atëherë, kemi nevojë për të kërkuar informacione shtesë apo shpjegime nga institucionet në lidhje me këto dy periudha?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

**Znj. M. Koja:** Kemi administruar ndërkohë për 11 institucione pretendimet. Duhet të presim deri në seancën e rradhës dhe do të dalim me vendimmarrje finale.

**Z. I. Celibashi:** Por ndërkohë jua kemi bërë me dije konstatimet.

**Znj. M. Koja:** Po, të gjitha janë dërguar.

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, do të vendosim ditën e mërkurë ndoshta për raportin e këtyre dy periudhave. Në lidhje me çfarë përfundon si shqyrtim administrativ. Atëherë vlerësojmë se do të duhet të sanksionohen Kryetari i Bashkisë Përrenjas, Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Kryetari i Bashkisë Fier në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, Për shkelje të normave që lidhen me veprimtaritë publike, vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator dhe dispozitave të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë po kështu sanksion administrativ për mosraportim të veprimtarive publike për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë të Turizmit dhe të Mjedisit; Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Poliçan; Bashkia Skrapar, personi përgjegjës për raportimet; Bashkia Roskovec, Sekretari i Përgjithshëm, Bashka Lezhë Sekretari i Përgjithshëm, Bashkia Bulqizë Sekretari i Përgjithshëm, Bashkia Lushnje, personi përgjegjës për raportimet; Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes; Drejtori i kabinetit i Ministrisë të Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, drejtori, person përgjegjës për Bashkinë Elbasan. Për të gjitha në masën e 5 000 (pesë mijë) lekëve.

**Vendimet nr. 200, 201, 202, 204.**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

24.03.2023  
Ora12:28

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**  
**Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**      **S’ka**
- **Të tjerë**      **Qëndresa Qytetëtare, KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në dt. 21.03.2023, me vendimin nr. 30, ka vendosur pranimin e Kërkesës Ankimore nr. 35, dt. 17.03.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, ndryshimin e vendimit nr. 173, dt. 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të regjistrojë partinë politike “Aleanca Progresiste LZHK” me kryetar zotin Dashamir Shehin, me shkronjat nisore LZHK, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në zbatim të vendimit të KAS-it partia politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me shkresën nr. 1312\1 ka paraqitur deklaratën e të dhënave të përcaktuara ku është shkruar emri zyrtar, shkronjat

**Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.03.2023*

nistore dhe adresa e partisë. Duke ju referuar vendimit të KAS-it i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të regjistrojë si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, partinë politike “Aleanca Progresiste LZHK”. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëherë, vendosim:

1. Regjistrimin e Partisë politike “Aleanca Progresiste LZHK” me shkronjat nisore LZHK, me kryetar zotin Dashamir Shehi, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Faleminderit, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 205**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

